FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 115

Tiranë – E premte, 3 korrik 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 18.6.2015	Për shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Pogradecit dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj.....	6029
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 39, datë 25.6.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-1796, datë 09.07.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë….....	6037
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 40, datë 25.6.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2013-1773 (422), datë 09.07.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	6043
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 41, datë 25.6.2015	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 79, datë 13.12.2013 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.....	6048
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 42, datë 25.6.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 3984, datë 20.06.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1035, datë 02.10.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2012-753 (96), datë 23.02.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	6051

VENDIM
Nr. 554, datë 18.6.2015

PËR SHPALLJEN E QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË POGRADECIT DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 29, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Pogradecit, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike të përcaktuara në të, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e rregullores së administrimit të Qendrës Historike të qytetit të Pogradecit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË POGRADECIT

Neni 1
Qëllimi dhe objektivat

Kjo rregullore përcakton detyrimet dhe mënyrat për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Pogradecit.

Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje, janë:

1. Administrimi i Qendrës Historike dhe i Zonës së Mbrojtur të qytetit të Pogradecit sipas hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj;
2. Mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike të qytetit të Pogradecit;
3. Mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore të qytetit të Pogradecit për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Qendrës Historike të qytetit të Pogradecit.

Neni 2
Struktura e hapësirës urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Pogradecit, për vlerat e saj historiko-kulturore dhe si pjesë e trashëgimisë kulturore, i nënshtrohet ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar me ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008, dhe vendimit nr. 426, datë 13.7.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimit".
2. Hapësira urbane me vlera historiko-kulturore në mbrojtje e qytetit të Pogradecit, përbëhet nga:

a) Qendra Historike;
b) Zona e Mbrojtur.

3. Kufijtë e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Pogradecit, e cila është pjesë e kësaj rregulloreje.
4. Plani i përgjithshëm vendor i qytetit të Pogradecit duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes së Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur.

Neni 3
Qendra Historike dhe kufijtë e saj

1. Qendra Historike e Pogradecit është hapësira me vlera të rëndësishme historike dhe urbanistiko-arkitekturore që dokumenton rrugën e zhvillimit historik të qytetit të Pogradecit dhe tiparet urbanistiko-arkitekturore që u formuan gjatë historisë së tij.
2. Qendra Historike përmbledh brenda kufijve të saj:

a) Ansamblin në Lagjen e Burimave (Topleci), i cili ruan rrjetin rrugor karakteristik dhe një sërë ndërtimesh, dëshmi e një periudhe të hershme të zhvillimit të qytetit;
b) Ansamblin përgjatë rrugës "Naim Frashëri", i cili dëshmon për proceset e reja që ndodhën gjatë zhvillimit të qytetit në fillimet e shek. XX, siç është formimi i arterieve tregtaro-shoqërore;
c) Ansamblin rreth rrugicës së ngushtë tërthor me rrugën "Naim Frashëri" (pjesë e lagjes së Angjellarëve), përfaqësues tipik i lagjeve të vjetra të qytetit, i cili ruan ende karakterin urbanistiko-arkitekturor fillestar.

3. Kufijtë e Qendrës Historike paraqiten në tabelën më poshtë me koordinata gjeografike, si edhe në hartën e zonifikimit të qytetit të Pogradecit, e cila është pjesë kësaj rregulloreje.

PËR SHPALLJEN QENDËR HISTORIKE TË QYTETIT TË POGRADECIT KOORDINATAT GJEOGRAFIKE						
	Gjatësi			**Gjerësi**		
pika	gradë	minuta	sekonda	gradë	minuta	sekonda
ZONA 1						
Z1	40°	54`	11.83``N	20°	39`	11.31``E
Z2	40°	54`	11.99``N	20°	39`	11.69``E
Z3	40°	54`	11.96``N	20°	39`	12.72``E
Z4	40°	54`	12.25``N	20°	39`	12.70``E
Z5	40°	54`	12.37``N	20°	39`	13.54``E
Z6	40°	54`	12.39``N	20°	39`	14.76``E
Z7	40°	54`	12.68``N	20°	39`	14.64``E
Z8	40°	54`	12.68``N	20°	39`	15.78``E
Z9	40°	54`	13.09``N	20°	39`	16.09``E
Z10	40°	54`	12.84``N	20°	39`	16.66``E
Z11	40°	54`	12.59``N	20°	39`	16.44``E
Z12	40°	54`	12.38``N	20°	39`	17.13``E
Z13	40°	54`	12.57``N	20°	39`	17.40``E
Z14	40°	54`	12.37``N	20°	39`	17.74``E
Z15	40°	54`	14.46``N	20°	39`	19.50``E
Z16	40°	54`	14.08``N	20°	39`	20.39``E
Z17	40°	54`	13.13``N	20°	39`	19.86``E
Z18	40°	54`	12.87``N	20°	39`	20.94``E
Z19	40°	54`	12.03``N	20°	39`	20.15``E
Z20	40°	54`	11.45``N	20°	39`	20.05``E
Z21	40°	54`	11.66``N	20°	39`	19.56``E
Z22	40°	54`	11.15``N	20°	39`	19.02``E
Z23	40°	54`	11.25``N	20°	39`	18.56``E
Z24	40°	54`	10.98``N	20°	39`	18.44``E
Z25	40°	54`	10.91``N	20°	39`	17.45``E
Z26	40°	54`	10.83``N	20°	39`	15.64``E
Z27	40°	54`	11.06``N	20°	39`	15.63``E
Z28	40°	54`	11.18``N	20°	39`	14.47``E
Z29	40°	54`	10.72``N	20°	39`	13.76``E
Z30	40°	54`	10.81``N	20°	39`	13.80``E
Z31	40°	54`	10.59``N	20°	39`	13.42``E
Z32	40°	54`	10.32``N	20°	39`	12.98``E
Z33	40°	54`	11.33``N	20°	39`	11.92``E
ZONA 2						
Z1	40°	54`	11.75``N	20°	38`	59.51``E
Z2	40°	54`	12.03``N	20°	39`	0.41``E
Z3	40°	54`	12.45``N	20°	39`	1.58``E
Z4	40°	54`	11.85``N	20°	39`	2.63``E

Z5	40°	54`	12.53``N	20°	39`	3.18``E
Z6	40°	54`	12.28``N	20°	39`	3.78``E
Z7	40°	54`	12.60``N	20°	39`	4.03``E
Z8	40°	54`	12.36``N	20°	39`	4.60``E
Z9	40°	54`	11.99``N	20°	39`	4.87``E
Z10	40°	54`	12.43``N	20°	39`	5.39``E
Z11	40°	54`	13.95``N	20°	39`	8.52``E
Z12	40°	54`	13.79``N	20°	39`	8.75``E
Z13	40°	54`	13.70``N	20°	39`	8.42``E
Z14	40°	54`	12.43``N	20°	39`	9.68``E
Z15	40°	54`	12.15``N	20°	39`	9.02``E
Z16	40°	54`	12.00``N	20°	39`	9.17``E
Z17	40°	54`	11.70``N	20°	39`	8.59``E
Z18	40°	54`	11.99``N	20°	39`	8.31``E
Z19	40°	54`	11.58``N	20°	39`	7.57``E
Z20	40°	54`	11.37``N	20°	39`	7.97``E
Z21	40°	54`	10.20``N	20°	39`	6.28``E
Z22	40°	54`	10.54``N	20°	39`	5.63``E
Z23	40°	54`	9.85``N	20°	39`	5.12``E
Z24	40°	54`	10.03``N	20°	39`	4.78``E
Z25	40°	54`	8.50``N	20°	39`	3.87``E
Z26	40°	54`	8.57``N	20°	39`	2.82``E
Z27	40°	54`	8.28``N	20°	39`	2.42``E
Z28	40°	54`	8.28``N	20°	39`	1.37``E
Z29	40°	54`	9.01``N	20°	39`	1.48``E
Z30	40°	54`	9.28``N	20°	39`	1.15``E
Z31	40°	54`	9.52``N	20°	39`	1.35``E
Z32	40°	54`	9.70``N	20°	39`	0.78``E
Z33	40°	54`	10.53``N	20°	39`	1.37``E

Neni 4

Ndërhyrjet e lejuara në Qendrën Historike

Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekturore të Qendrës Historike, brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

1. Ndërhyrjet sistematike konservuese, restauruese dhe të mirëmbajtjes në Qendrën Historike, si dhe në monumentet e të dyja kategorive. Këto ndërhyrje mbështeten në kriteret për konservimin dhe restaurimin, të saktësuara në aktet normative kombëtare dhe ndërkombëtare të fushës, të zbatueshme edhe në vendin tonë.

2. Në Qendrën Historike ndërhyrjet restauruese synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitekturore, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese dhe të bimësisë tradicionale.

3. Për Qendrën Historike kryhen studime për reabilitimin e pjesëve të veçanta të saj lidhur me qëndrimin kundrejt ndërtimeve, të cilat me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të saj.

4. Këto studime përcaktojnë objektet, ku kryhen punime konservuese dhe restauruese, objektet ku kryhen ritrajtime për të rritur vlerat e tyre, objektet në gjendje rrënoje ose të papërshtatshme për funksionim dhe që cenojnë unitetin arkitekturor të ansamblit ose të zonës, ku lejohet të kryhen rikonstruksione, zonat ku

lejohet të kryhen ndërhyrje integruese, si dhe parcelat e gjelbëruara.

5. Në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose të djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.

6. Ritrajtimet dhe rikonstruksionet duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të ansamblit apo të zonës, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve të vëna në mbrojtje dhe duke mos tejkaluar lartësinë maksimale të tyre.

7. Ndalohen ndërtimet e reja në Qendrën Historike, me përjashtim të rikonstruksionit të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve të përmendura në pikat më sipër.

Neni 5

Zona e Mbrojtur dhe kufijtë e saj

Zona e Mbrojtur shtrihet përreth Qendrës Historike. Ajo mbron vlerat e Qendrës Historike dhe krijon një kalim të butë prej saj drejt pjesëve të reja të qytetit. Zona e Mbrojtur ruhet në përbërësit urbanistikë, arkitekturorë dhe mjedisorë.

Kufijtë e Zonës së Mbrojtur paraqiten në tabelën e mëposhtme me koordinata gjeografike, si edhe në hartën e zonifikimit të qytetit të Pogradecit, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

PËR SHPALLJEN E ZONËS TË MBROJTUR TË QYTETIT TË POGRADECIT KOORDINATAT GJEOGRAFIKE						
	Gjatësi			**Gjerësi**		
pika	gradë	minuta	sekonda	gradë	minuta	sekonda
ZONA 1						
P1	40°	54`	11.82``N	20°	39`	11.33``E
P2	40°	54`	13.27``N	20°	39`	13.84``E
P3	40°	54`	13.54``N	20°	39`	14.01``E
P4	40°	54`	14.41``N	20°	39`	16.02``E
P5	40°	54`	14.26``N	20°	39`	16.28``E
P6	40°	54`	14.30``N	20°	39`	16.25``E
P7	40°	54`	13.45``N	20°	39`	16.23``E
P8	40°	54`	14.13``N	20°	39`	17.34``E
P9	40°	54`	15.20``N	20°	39`	18.15``E
P10	40°	54`	13.43``N	20°	39`	21.44``E
P11	40°	54`	12.03``N	20°	39`	20.15``E
P12	40°	54`	11.45``N	20°	39`	20.05``E
P13	40°	54`	11.06``N	20°	39`	20.56``E
P14	40°	54`	10.57``N	20°	39`	20.15``E
P15	40°	54`	10.20``N	20°	39`	19.73``E
P16	40°	54`	10.48``N	20°	39`	19.21``E
P17	40°	54`	10.60``N	20°	39`	17.97``E
P18	40°	54`	10.47``N	20°	39`	18.02``E
P19	40°	54`	10.54``N	20°	39`	17.65``E
P20	40°	54`	10.15``N	20°	39`	17.59``E
P21	40°	54`	9.75``N	20°	39`	17.21``E
P22	40°	54`	10.16``N	20°	39`	16.62``E

P23	40°	54`	9.51``N	20°	39`	15.79``E
P24	40°	54`	9.41``N	20°	39`	15.31``E
P25	40°	54`	10.09``N	20°	39`	14.66``E
P26	40°	54`	10.42``N	20°	39`	14.01``E
P27	40°	54`	10.81``N	20°	39`	13.80``E
P28	40°	54`	10.59``N	20°	39`	13.42``E
P29	40°	54`	10.32``N	20°	39`	12.98``E
P30	40°	54`	11.33``N	20°	39`	11.92``E
ZONA 2						
P1	40°	54`	11.48``N	20°	38`	58.42``E
P2	40°	54`	12.03``N	20°	39`	0.41``E
P3	40°	54`	13.14``N	20°	39`	3.21``E
P4	40°	54`	12.89``N	20°	39`	3.68``E
P5	40°	54`	13.84``N	20°	39`	6.15``E
P6	40°	54`	13.64``N	20°	39`	6.51``E
P7	40°	54`	13.30``N	20°	39`	6.75``E
P8	40°	54`	13.46``N	20°	39`	7.12``E
P9	40°	54`	12.49``N	20°	39`	7.60``E
P10	40°	54`	10.23``N	20°	39`	4.40``E
P11	40°	54`	10.17``N	20°	39`	4.65``E
P12	40°	54`	9.51``N	20°	39`	3.82``E
P13	40°	54`	9.30``N	20°	39`	3.98``E
P14	40°	54`	8.76``N	20°	39`	3.02``E
P15	40°	54`	7.89``N	20°	39`	2.30``E
P16	40°	54`	8.20``N	20°	39`	1.90``E
P17	40°	54`	8.12``N	20°	39`	1.36``E
P18	40°	54`	7.98``N	20°	39`	1.24``E
P19	40°	54`	7.54``N	20°	39`	0.23``E
P20	40°	54`	10.13``N	20°	39`	59.77``E
P21	40°	54`	8.85``N	20°	39`	59.04``E
P22	40°	54`	10.13``N	20°	39`	58.81``E

Neni 6

Ndërhyrjet në Zonën e Mbrojtur

1. Në Zonën e Mbrojtur ruhet rrjeti rrugor në kompozimin dhe në formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik. Në këtë zonë kryhen restaurime, përshtatje, rikonstruksione apo dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj dhe për përmirësimin e kushteve të jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të ansamblit.

2. Nuk lejohen ndryshimet në rrjetin rrugor ekzistues përveç rikonstruksionit të tij. Ndërhyrjet e rikonstruksionit në rrjetin rrugor dhe sheshe ruajnë detyrimisht materialet dhe teknikat tradicionale.

3. Lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve nuk duhet t'i kalojë 3 katet dhe jo më tepër se 10 m deri në kornizën e çatisë.

4. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.

5. Projektet për përshtatjet, rikonstruksionet apo dhe ndërtimet e reja miratohen nga Këshilli

Kombëtar i Restaurimeve dhe, më pas, procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

Neni 7
Ndarja e monumenteve sipas kategorive

1. Monumentet e kulturës në qytetin e Pogradecit, sipas vlerave të tyre historiko-kulturore ndahen në dy kategori:
a) monumente të kategorisë së parë;
b) monumente të kategorisë së dytë.
2. Ato ndodhen në Qendrën Historike, në Zonën e Mbrojtur ose në pjesët e tjera të qytetit. Kjo ndarje sipas vlerave, pasqyrohet në shkallën e ruajtjes së tyre, si dhe në mënyrat dhe shkallën e ndërhyrjes konservuese e restauruese.

Neni 8
Monumentet e kategorisë së parë

1. Monumentet e kategorisë së parë janë ndërtime me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitekturore, që pasqyrojnë zhvillimin tipologjik dhe karakteristikat arkitektoniko-teknike të banesës tradicionale korçare.
2. Monumentet e kategorisë së parë, me shkallë të mirë autenticiteti, ruhen në përbërësit kompozicionalë, arkitekturorë, teknikë dhe të materialeve të ndërtimit. Oborri, muret rrethuese, porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse janë pjesë organike e monumentit dhe, si të tilla, i nënshtrohen të njëjtit trajtim.
3. Monumentet e kategorisë së parë ruhen në Qendrën Historike, në Zonën e Mbrojtur dhe në pjesën tjetër të qytetit.
4. Në monumentet e kategorisë së parë kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme dhe të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike dhe funksionale, nuk mund të ndryshohen, me përjashtim të vendosjes së nyjës higjieno-sanitare, kur është e domosdoshme dhe kur nuk cenon vlerat për të cilat është vënë në mbrojtje. Në rastet kur një pjesë e monumentit ka pësuar dëmtime, transformime ose mungon, mund të ndërmerren ndërhyrje plotësuese sipas gjendjes fillestare.
5. Deri në shpalljen e Zonës së Mbrojtur të monumenteve të kategorisë së parë, nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me nenin 32, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, për aq sa nuk bie në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, nuk lejohen ndërtime të reja në pronat kufitare me monumentin e kulturës.
6. Trajtimi i objekteve ekzistuese kufitare të shqyrtohet në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR) rast pas rasti.

Neni 9
Monumentet e kategorisë së dytë

1. Monumentet e kategorisë së dytë janë ndërtime me vlera historiko-kulturore, kryesisht si formuese të ansambleve urbanistiko-arkitekturore, marrin pjesë në formulimin kompozicional të qytetit, por edhe ruajnë vlera arkitekturore në vetvete.
2. Monumentet e kategorisë së dytë ruhen në volumet e tyre fillestare dhe trajtimin e tyre arkitekturor të pamjes së jashtme, duke përfshirë materialet dhe teknikat tradicionale.
3. Në brendësi të monumenteve të kategorisë së dytë lejohen ndryshime të strukturës kompozicionale dhe përdorimi i teknikave bashkëkohore, pa cenuar formulimin e pamjes së jashtme.

Neni 10
Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Qendrën Historike dhe në monumente të veçanta

1. Projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës bëhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjekte të licencuara për këtë qëllim. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK) dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR).
2. Zbatimi i punimeve të mësipërme kryhet prej Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë (DRKK) ose prej subjekteve të licencuara për restaurim, nën mbikëqyrjen e supervizorit dhe kolaudatorit, caktuar prej IMK-së. Për monumentet e kulturës pronë private, pjesa e shpenzimeve që i takon pronarit dhe mënyra e shlyerjes së tyre bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Studimet dhe projektet e rikonstruksioneve të përmendura në pikat 3, 4, 5 dhe 6, të nenit 4, hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare

Korçë (DRKK) ose nga persona të licencuar në fushën e restaurimeve për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

4. Studimet dhe projektet për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhinierik hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë, në bashkëpunim me Bashkinë e Pogradecit ose nga persona të licencuar në fushën e restaurimeve dhe në kategoritë përkatëse të punimeve. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

Neni 11
Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Zonën e Mbrojtur

1. Studimet për rehabilitimin e imazhit të Zonës së Mbrojtur hartohen nga Instituti i Monumenteve e Kulturës, Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec ose nga subjekte të licencuara në fushën e restaurimeve, sipas rregullores së miratuar. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

2. Projektet e rikonstruksionit të ndërtesave në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

3. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet prej subjekteve ndërtimore që janë të licencuar për këtë kategori.

4. Projektet për ndërtimet e reja në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

5. Projektet e rikonstruksionit të rrugëve, të shesheve dhe të infrastrukturës së tyre, të përmendura në nenin 6, hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë përkatëse në fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

Neni 12
Shfrytëzimi i monumenteve

Monumentet e kulturës janë pjesë e jetës urbane të qytetit. Ato shfrytëzohen, sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar apo dhe për funksione të tjera, me kusht që këto funksione të mos cenojnë vlerat për të cilat monumenti është vënë në mbrojtje. Shfrytëzimi i monumenteve të kulturës për funksione të ndryshme nga ato për të cilat janë ngritur bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve. Mënyrat e përdorimit përcaktohen në ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar.

Neni 13
Mbrojtja e monumenteve

Organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e monumenteve të ngritura në hapësirat e juridiksionit të tyre.

Plani rregullues i qytetit të Pogradecit, detyrimisht, merr parasysh vlerat e Qendrës Historike.

Neni 14
Komiteti Mbikëqyrës i Qendrës Historike

Për të ndihmuar dhe për të mbikëqyrur veprimtarinë dhe vlerësimin e Qendrës Historike dhe monu-menteve të kulturës në qytetin e Pogradecit, pranë bashkisë së qytetit ngrihet Komiteti Mbikëqyrës i Qendrës Historike. Ky komitet është një strukturë këshillimore dhe jo vendimmarrëse, i cili përbëhet nga 7 anëtarë. Kryetari i këtij komiteti caktohet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore të qytetit dhe ka në përbërjen e tij përfaqësues të institucioneve shtetërore të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, të shoqatës së arkitektëve të qytetit, të

përfaqësuesve të banorëve të Qendrës Historike dhe organizmave joshtetërorë që ushtrojnë veprimtari për mbrojtjen e vlerave historiko-kulturore të qytetit të Pogradecit. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtij komiteti përcaktohet në rregulloren e funksionimit të brendshëm, që miratohet me 50%+1 të votave të të gjithë anëtarëve.

Neni 15
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe, për pasojë, nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave, ato zgjidhen prej Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Neni 16
Kundërvajtjet administrative

Shkelja e kësaj rregulloreje ngarkon me përgjegjësi kundërvajtësit, sipas dispozitave të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, dhe Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 17
Dispozita të fundit

1. Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Kësaj rregulloreje i bashkëlidhet harta e zonifikimit të Qendrës Historike dhe të Zonës së Mbrojtur të qytetit të Pogradecit.

3. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, Instituti i Monumenteve të Kulturës, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë, i paraqet ministrit përgjegjës listën e monumenteve të kulturës të kategorisë së parë e të dytë për shqyrtim dhe miratim.

VENDIM
Nr. 39, datë 25.6.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i " "
Sokol Berberi	anëtar i " "
Vitore Tusha	anëtar i " "
Altina Xhoxhaj	anëtare e " "
Gani Dizdari	anëtar i " "
Besnik Imeraj	anëtar i " "
Fatos Lulo	anëtar i " "
Fatmir Hoxha	anëtar i " "

me sekretare Edmira Babaj, në datën 24.02.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 3 Akti, që i përket:

KËRKUES: Astrit Manopulli

SUBJEKT I INTERESUAR: Partia Socialdemokrate e Shqipërisë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2014-1796, datë 09.07.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:
I

1. Kërkuesi Astrit Manopulli është pronar i pasurisë truall me sipërfaqe 1380 m², i banesës dykatëshe, si dhe i objekteve të tjera të ndërtuara mbi këtë truall. Kufijtë e pasurisë janë të përcaktuar sipas regjistrimit hipotekar me nr. 3188,

datë 18.07.1997 të Zyrës Vendore të Pasurive të Paluajtshme në Tiranë. Kërkuesi, me pretendimin se trualli posedohet në mënyrë të paligjshme prej subjektit të interesuar Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë (në vijim PSD-ja), i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi me objekt detyrimin e subjektit të interesuar PSD-së të njohë të drejtën e posedimit dhe të pushojë cenimin në godinën objekt gjykimi.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2827, datë 31.03.2008, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit si të pambështetur në ligj dhe në prova, duke e konsideruar posedimin e PSD-së të ligjshëm bazuar në shkresën nr. 1371, datë 06.07.1991 të Këshillit të Ministrave.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1661, datë 04.12.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2827, datë 31.03.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-20-30 (330), datë 04.06.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1661, datë 04.12.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 2827, datë 31.03.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me një tjetër trup gjykues.

5. Ndërkohë, kërkuesi i është drejtuar përsëri Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi me objekt detyrimin e subjektit të interesuar për shpërblimin nga përdorimi i pasurisë së mësipërme.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1780, datë 08.03.2010, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë. Detyrimin e subjektit të interesuar të paguajë vlerën e përdorimit të sendit prej datës 01.08.2009 dhe rrëzimin për kërkimet e tjera.

7. Mbi ankimin e subjektit të interesuar, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1349, datë 09.06.2011, ka ndryshuar vendimin nr. 1780, datë 08.03.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur rrëzimin e padisë.

8. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2014-1796, datë 09.07.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit.

II

9. *Kërkuesi Astrit Manopulli* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë gjykimit nga Kolegji Civil i Gjykatës e Lartë (dhomë këshillimi). Më konkretisht, ai ka parashtruar si vijon:

9.1 Është cenuar parimi i arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), pasi nuk u është dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në rekurs. Ky kolegj, megjithëse në rekurs ishin parashtruar shkaqe të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur mospranimin e rekursit.

9.2 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, ka marrë një vendim të papajtueshëm me Kushtetutën. Pretendimet e parashtruara në rekurs kanë të bëjnë me keqzbatimin e ligjit, shkak i parashikuar prej nenit 472 të KPC-së.

10. *Subjekti i interesuar, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë*, ka paraqitur prapësime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

10.1. Pretendimi i kërkuesit për cenim të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk janë përmendur dhe nuk janë arsyetuar shkaqet e mospranimit të rekursit, është i pabazuar.

10.2. Pretendimet e kërkuesit nuk i referohen asnjë standardi kushtetues të zhvilluar nga Gjykata Kushtetuese. Rekursi është kontradiktor, pasi i referohet zbatimit të gabuar të nenit 297 të KPC-së nga Gjykata e Apelit Tiranë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin

11. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës, pasi parashikohet si subjekt nga neni 134/1/g i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*ratione personae*), *ratione materiae*, si edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30, pika 2, i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

12. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2014-1796, datë 09.07.2014, ka

cenuar parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Kolegji nuk i ka shqyrtuar pretendimet e parashtruara në rekurs, megjithëse përbënin shkelje të parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

13. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ripohon se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar.

14. Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpër-mendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete, natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata çmon të sjellë në vëmendje karakteristikat e procesit që zhvillohet në Kolegjin e Gjykatës së Lartë, i cili është organi që analizon dhe vlerëson në dhomë këshillimi nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t'u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Neni 475, pika "ç", i KPC-së parashikon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese qëndron në vlerësimin të këtyre shkaqeve. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve, bazuar në nenin 480 të KPC-së.

16. Si për kalimin në seancë, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit luan rolin e një filtri paraprak përzgjedhës të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Sigurisht që palët përpara kësaj trupe gjyqësore, në një numër të madh rastesh, *prima facie* i plotësojnë formalisht kriteret që kërkesa e tyre të shkojë në seancë publike, por kjo nuk mund t'ia deformojë funksionin vlerësues dhomës së këshillimit (*shih vendimin nr. 18, datë 18.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit, për verifikimin nëse rekursi i plotëson ose jo kushtet për shqyrtim, nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës apo të asaj për një gjykim publik, por është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimin nr. 45, datë 23.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Nga parashikimet e normave të mësipërme procedurale, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimin nr. 3, datë 19.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në çështjen konkrete Gjykata Kushtetuese vëren se vendimi nr. 00-2014-1796, datë 09.07.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) për mospranimin e rekursit përmban në pjesën e tij hyrëse palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe shkaqet në bazë të të cilave kërkuesi ka pretenduar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

19. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) në përfundim është shprehur se rekursi i paraqitur me shkaqet e përmendura nuk përmbush kriteret e parashikuara nga ligji, pasi nuk përmban asnjë prej rasteve që parashikon neni 472 i KPC-së, duke vendosur në pjesën urdhëruese mospranimin e tij.

20. Bazuar në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile është në kompetencë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se

Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

21. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2014-1796, datë 09.07.2014 për mospranimin e rekursit, nuk ka cenuar parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

C. Për pretendimet e tjera

22. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, ka marrë një vendim të papajtueshëm me Kushtetutën. Pretendimet e parashtruara në rekurs kanë të bëjnë me keqzbatimin e ligjit, shkak i parashikuar prej nenit 472 të KPC-së.

23. Në çështjen në shqyrtim Gjykata Kushtetuese konstaton se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi në rekurs, si dhe në kërkesën drejtuar kësaj Gjykate kanë të bëjnë me mënyrën se si gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin material. Në thelb pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e nenit 297 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

24. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur në mënyrë të vazhdueshme se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata Kushtetuese ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor për palët në gjykim dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit gjyqësor (*shih vendimet nr. 19, datë 02.04.2012; nr. 26, datë 15.12.2008; nr. 7, datë 27.04.2005; nr. 106, datë 01.08.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në përfundim, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimi i kërkuesit Astrit Manopulli është i pabazuar, për pasojë kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja "g", të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Vitore Tusha

MENDIM PAKICE

Jam kundër vendimit të shumicës për arsyet e mëposhtme:

1. Kërkuesi Astrit Manopulli ka kërkuar nga kjo Gjykatë shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-1796, datë 09.07.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

2. Në thelb kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, duke ndryshuar një vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili kishte vendosur detyrimin e subjektit të interesuar për t'i paguar kërkuesit vlerën e përdorimit të sendit, është një vendim i padrejtë, pasi edhe pse kërkuesi është njohur si pronar i ligjshëm i pasurisë nga të dyja vendimet e gjykatave të faktit, ai është privuar nga e drejta për të gëzuar dhe poseduar pasurinë, apo qoftë për të përfituar shpërblimin për shkak të përdorimit të sendit nga të tjerët. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) nuk ka argumentuar, sipas kërkuesit, mbi këto fakte, arsye për të cilën ai pretendon se vendimi i këtij Kolegji nuk plotëson as standardet minimale të arsyetimit të vendimit.

3. Sikurse jam shprehur edhe më parë (shih mendimet paralele të vendimeve nr. 3, datë 19.02.2013; nr. 26, datë 24.06.2013; nr. 37, datë 30.06.2014 të Gjykatës Kushtetutës), jam i

mendimit se pretendimi i kërkuesit është i drejtë dhe i bazuar dhe si i tillë duhej pranuar.

4. Sipas këndvështrimit tim, në një shtet të së drejtës gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të jenë aktive për t'i zgjidhur drejt konfliktet, sepse jo gjithmonë zgjidhjet ligjore janë detyrimisht edhe të drejta. Në këtë drejtim mendoj se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i pazëvendësueshëm. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta. Kam parasysh këtu, veç të tjerave, edhe të drejtën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të marrë vendime për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore.

5. Çështja objekt shqyrtimi paraqet veçori të kësaj natyre pikërisht për faktin se për sa i përket garantimit dhe respektimit të së drejtës së pronës së pronarëve të ligjshëm, GJEDNJ-ja ka konstatuar dështimin e vazhdueshëm të autoriteteve kompetente shqiptare për të marrë masat e duhura ligjore, administrative e buxhetore për të hequr të gjitha pengesat për dhënien e kompensimit për pronat e shtetëzuara ose të shpronësuara, për të parashikuar rregullat procedurale dhe për t'i zbatuar ato në praktikë, si dhe për të zbatuar vendimet gjyqësore dhe ato administrative në funksion të njohjes së të drejtave të pronësisë. Ajo ka vlerësuar se këto mangësi vazhdojnë të çojnë në ndërhyrje të pajustifikuara në të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë, në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Po ashtu dështimi i vazhdueshëm në përcaktimin e afateve të qarta kohore për kthimin e pronës *bona fide* krijon gjendje pasigurie në lidhje me realizimin e të drejtave të pronësisë, duke i ngarkuar pronarët e ligjshëm me një peshë jopërpjesëtimore dhe të tepërt (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet "Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë", datë 12.02.2007; "Driza kundër Shqipërisë", datë 02.06.2008;"Ramadhi kundër Shqipërisë", datë 02.06.2008).*

6. Nën dritën e vendimeve të GJEDNJ-së, të cilat mundësojnë një zgjidhje më të shpejtë dhe më efektive të situatës jofunksionale, që cenon në vazhdimësi, për një periudhë gati 20-vjeçare, të drejtën e pronës, mendoj se në zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi, si çështje jo vetëm me interes publik, por para së gjithash me natyrë kushtetuese, rol të rëndësishëm, përveç vendimmarrjes së kësaj Gjykate, ka edhe Gjykata e Lartë.

7. Në rastin në shqyrtim, dy gjykata të niveleve të ndryshme, ajo e shkallës së parë dhe ajo e apelit, i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta zgjidhjes së konfliktit mbi të drejtën e shpërblimit të kërkuesit, në cilësinë e pronarit të sendit në përdorim nga të tretët (subjekti i interesuar). Ndonëse të dyja vendimet nga pikëpamja formale juridike janë të argumentuara dhe të bazuara në ligj, vetëm njëri prej tyre është dhe duhet të jetë i drejtë. Prandaj për zgjidhjen e këtij problemi kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë, duke kërkuar prej saj, si gjykatë më e lartë, të bëjë rolin e "arbitrit" për një gjykim të padrejtë që ka bërë Gjykata e Apelit Tiranë, e cila, sipas tij, ndër të tjera, jo vetëm ka interpretuar gabim ligjin material, por ka cenuar dhe të drejtën e pronës. Këtyre pretendimeve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përgjigjet me një vendim standard formal mospranimi të rekursit, i cili nuk përmban asnjë arsyetim jo vetëm për të kuptuar shkaqet e këtij qëndrimi, por edhe për ta përligjur vendimmarrjen e tij. Arsyetimi i vendimit (qoftë edhe me një argumentim të shkurtuar të pretendimeve) është detyrim kushtetues që buron nga neni 142/1 i Kushtetutës dhe kodet procedurale.

8. Nga kjo pikëpamje, Gjykata ka vlerësuar se në të tilla raste (që shqyrtohen rast pas rasti) kërkuesit, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, por edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 3, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Si përfundim, në rastin objekt shqyrtimi, duke qenë se vendimi i gjykatës së apelit ka qenë diametralisht i kundërt me atë të gjykatës së shkallës së parë, me qëllim që kërkuesit t'i garantohej e drejta për t'u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij, vlerësoj se Gjykata e Lartë duhej të shprehej lidhur me themelin e çështjes, duke respektuar në këtë mënyrë edhe nga pikëpamja substanciale të drejtën e tij të ankimit.

Anëtar: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me argumentet dhe përfundimin e arritur në çështjen konkrete, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Kërkuesi ka parashtruar, midis të tjerash, se pretendimet e ngritura në rekurs kanë të bëjnë me keqzbatimin e ligjit dhe për sa kohë ky shkak parashikohet nga neni 472 i KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet të vendoste shqyrtimin e rekursit në seancë plenare dhe jo mospranimin në dhomë këshillimi. Këto pretendime të kërkuesit shumica i kualifikon si "*pretendime të tjera*", por nëse i referohemi jurisprudencës kushtetuese dhe veçanërisht parimit *iura novit curia* shumica kishte mundësinë t'i vlerësonte vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë binin në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj, dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi. Në rastin konkret, nisur nga faktet e pretenduara nga kërkuesi mendojmë se shumica duhet t'i vlerësonte ato nën dritën e së drejtës së kërkuesit për të pasur akses në Gjykatën e Lartë.

3. Shumica, në lidhje me "pretendimet e tjera", ka konstatuar se ato kanë të bëjnë me mënyrën se si gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin material, konkretisht nenin 297 të Kodit Civil (shih § 23 të vendimit). Ky konstatim ka qenë i mjaftueshëm që shumica të arsyetojë se "... *Gjykata Kushtetuese ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor për palët në gjykim dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit gjyqësor.*". Bazuar në këtë linjë arsyetimi shumica ka arritur në përfundimin se ... *"pretendimi i kërkuesit Astrit Manopulli është i pabazuar, për pasojë kërkesa duhet të rrëzohet." (shih §§ 24-25 të vendimit*).

4. Shumica me të drejtë nënvizon në vendim një kompetencë thelbësore të Gjykatës Kushtetuese, konkretisht *vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor për palët në gjykim dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes*. Por në referim të përmbajtjes së vendimit ky vlerësim mungon, sepse në realizimin e kësaj kompetence fillimisht shumica duhet të analizonte nëse Gjykata e Lartë e ka përmbushur efektivisht funksionin e saj si garantuese e respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga Gjykata e Apelit dhe në varësi të përfundimit në të cilën do të arrinte analiza e mësipërme, shumica duhet përcaktonte rolin që i takon Gjykatës Kushtetuese, bazuar në parimin e subsidiaritetit (komplementaritetit). Gjykata Kushtetuese ndërhyn në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 dhe 131, shkronja "f" e Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 16, datë 19.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Bazuar në standardin e mësipërm vlerësojmë se analiza e shumicës është e pamjaftueshme për të arritur në përfundimin se kërkesa e kërkuesit është e pabazuar, për faktin se ajo nuk i ka dhënë kuptimin e duhur së drejtës kushtetuese për akses substancial të kërkuesit në Gjykatën e Lartë.

6. Sipas Gjykatës së Apelit "... *pretendimet e paditësit në padi dhe gjykim kanë të bëjnë me kërkimin e dëmshpërblimit të dëmit sipas vlerës së përdorimit të sendit, që është një koncept i ndryshëm juridik nga ai i përcaktuar në nenin 297 të Kodit Civil... Sipas nenit 297 të KC-së e drejta e përfitimit të përdorimit të sendit nga poseduesi ndaj pronarit lind nga momenti i ngritjes së padisë për kërkimin e sendit dhe kjo dispozitë ka të bëjë me kapitullin e mbrojtjes së pronësisë dhe paditë për*

kërkimin e sendit...Me pak fjalë padia e ngritur nga paditësi në lidhje me vlerën e përdorimit të sendit sipas nenit 297 të KC-së është e lidhur me të drejtën e kthimit të sendit. Nëse nuk ekziston kthimi i sendit, atëherë edhe padia në lidhje me dëmshpërblimin për përfitimin e përdorimit të sendit nuk mund të qëndrojë sipas nenit 297/2 të KC-së...".

7. Mënyra se si Gjykata e Apelit e ka interpretuar kuptimin dhe raportin midis neneve 296 dhe 297 të KC-së bie ndesh me praktikën gjyqësore dhe trajtimet teoriko-doktrinore, ku mbizotëron edhe qëndrimi se padia për shpërblimin e përdorimit të sendit nga poseduesi i ligjshëm ose i paligjshëm mund të qëndrojë edhe si padi më vete, pa qenë domosdoshmërish e lidhur me kërkimin e sendit nga pronari. Madje interpretimi i Gjykatës së Apelit mbi dispozitat e zbatueshme në mosmarrëveshjen konkrete (nenet 608 e 609 të KC-së dhe jo 297) ngre dyshime serioze edhe për cenimin e parimit të disponibilitetit të padisë, pra të së drejtës së kërkuesit (paditësit) për të disponuar mbi objektin e padisë, i cili e ushtron duke bërë ndryshimet, shtesat apo pakësimet e objektit të padisë sipas interesave të tij. Bazuar edhe në qëndrimin e jurisprudencës kushtetuese, ku pretendimet që kanë të bëjnë me shkeljen e parimit të disponibilitetit janë trajtuar gjerësisht, si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, mendoj se Gjykata e Apelit jo vetëm ka diktuar objektin e padisë, por gjithashtu ka penguar paditësin në ushtrimin e të drejtës për të disponuar mbi këtë objekt, duke i cenuar atij të drejtën për akses në gjykatë si standard i procesit të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 6, datë 15.04.2005; nr. 16, datë 19.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese*)

8. Në vështrim të sa më sipër vlerësojmë se për shkak të natyrës së pretendimeve të kërkuesit në lidhje me kuptimin e ndryshëm që i kanë dhënë gjykatat e shkallëve më të ulëta nenit 297 të KC-së, Kolegji Civil ndodhej përpara detyrimit të përcaktonte kuptimin përfundimtar të këtij neni në funksion të garantimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës së pronësisë të kërkuesit i cili është pronar i sendit të poseduar nga i padituri. Për rrjedhojë, mendojmë se vendimi për mospranimin e rekursit përbën mohim të së drejtës të kërkuesit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura. Në këtë kuptim përbën edhe cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 6, datë 10.02.2014; nr. 4, datë 23.02.2011; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 7, datë 11.03.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në vështrim të sa më sipër vlerësojmë se pretendimet e kërkuesit mbi procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë ishin të bazuara, për rrjedhojë shumica duhet të kishte vendosur pranimin e kërkesës dhe vendimi i Gjykatës së Lartë duhet të ishte shfuqizuar me qëllim garantimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha

VENDIM
Nr. 40, datë 25.6.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar	i	"	"
Vitore Tusha	anëtar	i	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtar	i	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar	i	"	"
Gani Dizdari	anëtar	i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar	i	"	"
Fatos Lulo	anëtar	i	"	"
Sokol Berberi	anëtar	i	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 10.03.-2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 8 Akti, që i përket:

KËRKUES: Thoma Lloci

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) Tiranë

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Sarandë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2013-1773 (422), datë 09.07.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të

Drejtat e Njeriut dhe ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe, pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi, në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. 1916 rep., 448 kol., datë 02.04.2005, do të ndërtonte një godinë banimi dhe ambiente shërbimi në truallin me sipërfaqe 200m^2 në pronësi të shtetaseve L.D., B.D. dhe E.D., pasi të merrte lejen e ndërtimit nga organet kompetente. Pas lidhjes së kontratës së sipërmarrjes kërkuesi ka bërë kërkesë në KRRT-në Sarandë për miratimin e sheshit të ndërtimit prej 462 m^2. Në datën 14.02.2006 kërkuesi ka marrë leje nga Bashkia Sarandë për ndërtimin e një godine banimi, ambiente shërbimi dhe garazhe.

2. Me kontratën e shitjes nr. 552/421, datë 07.12.2006, shtetaset L.D., B.D., dhe E.D kanë blerë nga Bashkia Sarandë truallin me sipërfaqe 262 m^2, duke mbuluar kështu gjithë sipërfaqen e përcaktuar në lejen e ndërtimit të marrë nga kërkuesi.

3. Pas mbarimit të ndërtimit kërkuesi ka bërë kërkesë për regjistrimin e objektit në ZRPP. Me urdhrin nr. 270, datë 04.04.2008 të ZRPP-së Tiranë është refuzuar regjistrimi i objektit, pasi është konstatuar se kontrata e shitblerjes nr. 552/421, datë 07.12.2006 është bërë në kundërshtim me ligjin për shitblerjen e trojeve.

4. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila, me vendimin nr. 748, datë 16.07.2008, ka vendosur: "Pranimin e kërkesëpadisë së kërkuesit, anulimin e urdhrit nr. 270, datë 04.04.2008 të ZRPP-së Tiranë, detyrimin e palës së paditur, ZVRPP-së Sarandë, të kryejë regjistrimin e objektit [...] sipas kondicioneve urbane të përcaktuara në vendimin nr. 48, datë 25.09.2006 të Këshillit Bashkiak Sarandë, vendimit nr. 3/1, datë 14.02.2006 të KRRT-së, Bashkia Sarandë dhe dokumentacionit bashkëngjitur shkresës nr. 1390, datë 24.12.2007 të Drejtorisë së Urbanistikës së Bashkisë Sarandë".

5. Gjykata e Apelit Gjirokastër, pas ankimit të ushtruar nga subjekti i interesuar, ZVRPP-ja Sarandë, me vendimin nr. 405 (20-2008-544), datë 04.11.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 748, datë 16.07.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-1773 (422), datë 09.07.2013, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 748, datë 16.07.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe vendimit nr. 405 (20-2008-544), datë 04.11.2008 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

II

7. ***Kërkuesi*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë. Më konkretisht, ai ka parashtruar se:

7.1 Është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në themel, duke rivlerësuar provat e marra nga gjykatat dhe duke vendosur në kundërshtim me to.

7.2 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pa thirrur dhe pa dëgjuar palët e interesuara në kontratën e shitblerjes, që lidhet me vendimet gjyqësore të shqyrtuara prej saj, duke cenuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe parimin e kontradiktoritetit në gjykim.

7.3 Kolegji Civil i Gjykatë së Lartë ka gabuar në interpretimin dhe zbatimin e ligjit për pavlefshmërinë e kontratës administrative dhe të veprimit juridik në thelb të çështjes.

7.4 Me qëndrimin ndaj fitimit të pronësisë të mbajtur në vendimin që kundërshtohet, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike në lidhje me pronën e fituar kohë më parë.

8. ***Subjekti i interesuar***, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Sarandë, ka dërguar një shkresë ku bën me dije se në bazë të verifikimit të regjistrit hipotekor,

kërkuesi ka të regjistruar pasurinë "sipërfaqe trualli prej 462 m^2, si dhe objektin e ndërtuar në të [...] me sipërfaqe ndërtimi prej 225 m^2". Kjo pasuri është regjistruar në bazë të vendimit gjyqësor nr. 748, datë 16.07.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A.Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj

9. Kërkuesi ka pretenduar se është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në themel, rivlerësuar provat e marra nga gjykatat e shkallëve më të ulëta, duke mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga ato dhe duke tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes.

10. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një "gjykatë e caktuar me ligj". Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 2, datë 22.01.2014; nr. 27, datë 24.06.2013; nr. 22, datë 22.07.2009; nr. 31, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në të drejtën procedurale civile kufijtë brenda të cilëve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shqyrton çështjet mbi rekursin e ushtruar janë parashikuar në nenet 472 dhe 485 të KPC-së. Sipas nenit 472 të KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, kurse neni 485 i KPC-së i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dyja gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 27, datë 24.06.2013; nr. 7, datë 09.03.2009; nr. 31, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.06.2013 dhe nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 27, datë 24.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në çështjen në shqyrtim, objekti i gjykimit në themel ka qenë, ndër të tjera, anulimi i aktit administrativ, konkretisht urdhrit nr. 270, datë 04.04.2008 të Kryeregjistruesit, si i pabazuar në ligj dhe prova. Gjykata e Lartë është shprehur në

përmbajtjen e vendimit të saj se: "neni 3 i ligjit nr. 7980/1995 ka përcaktuar rastet përjashtimore kur mund të realizohet kalimi i trojeve të lira nga pronë shtetërore në pronë private [...] Në rastin objekt gjykimi nuk vërtetohet që paditësi Thoma Lloci të ketë vërtetuar që ndodhet përpara këtyre rasteve përjashtimore [...] Në rastin në gjykim gjykatat ishin të detyruara të arsyetonin nëse urdhri i Kryeregjistruesit është i ligjshëm apo i paligjshëm dhe nëse pronësia e truallit dhe godina që kërkohen të regjistrohen janë përfituar dhe ndërtuar në përputhje me ligjin". Për sa i përket kontratës së shitblerjes, Gjykata e Lartë e ka vlerësuar si një veprim juridik të kryer në kundërshtim me ligjin (nenin 3 të ligjit 7980/1995) dhe, si të tillë, absolutisht të pavlefshëm, ndërkohë që gjykatat e faktit (gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit) e kanë konsideruar kontratën në fuqi, përderisa nuk ka kontestime nga palët apo persona të tretë që cenohen nga kontrata (shih fq. 5 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe fq. 4 të vendimit të gjykatës së apelit).

14. Nisur nga arsyetimi i mësipërm, Gjykata e Lartë lë të nënkuptohet se, sipas saj, hetimi gjyqësor nga gjykatat e faktit ka qenë i paplotë dhe i pamjaftueshëm. Në çështjen konkrete Gjykata rithekson jurisprudencën e saj, sipas së cilës Gjykata e Lartë nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës së faktit nëse vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit. Nëse Kolegji Civil arrin në një përfundim të ndryshëm nga gjykatat e faktit, atëherë ai duhet të prishë të dyja vendimet gjyqësore dhe ta kthejë për rigjykim çështjen në gjykatën e shkallës së parë. Ai në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel, duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj të elaboruar më lart nga Gjykata (*shih vendimet 36, datë 30.06.2014; nr. 27, datë 24.06.2013; nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Gjykata e Lartë ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit në këtë drejtim është i bazuar dhe duhet pranuar.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të kontradiktoritetit në gjykim

16. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pa thirrur dhe pa dëgjuar palët e interesuara në kontratën e shitblerjes, që lidhet me vendimet gjyqësore të shqyrtuara prej saj. Konkretisht, sipas tij, nuk janë thirrur dhe nuk janë dëgjuar nga Gjykata e Lartë as Këshilli i Rrethit Sarandë, në cilësinë e shitësit, as pjesëtarët e familjes Drazho, në cilësinë blerësit, pavarësisht se veprimet e kryera prej tyre Gjykata e Lartë i konsideron të pavlefshme. Mosthirrja në gjykim e këtyre palëve ka cenuar parimin e kontradiktoritetit në gjykim.

17. Kriteri kushtetues i "detyrimit për të justifikuar interesin", i përcaktuar në pikën 2 të nenit 134 të Kushtetutës, është interpretuar nga jurisprudenca kushtetuese si përcaktues i ndarjes së rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori, subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Në këtë kuptim, kërkuesi, si subjekt i kushtëzuar i parashikuar në shkronjën "g" të paragrafit 1 të nenit 134 të Kushtetutës, mund të bëjë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij. Pretendimet konkrete që ngre kërkuesi kanë të bëjnë me subjekte të cilat nuk janë palë në çështjen e themelit, objekt i vendimit gjyqësor të dhënë nga Gjykata e Lartë.

18. Për pasojë, Gjykata vlerëson se kërkuesit i mungon interesi vetjak për të ngritur pretendimin konkret, i cili në këto kushte nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

C. Për pretendimin e zbatimit dhe të interpretimit të gabuar të ligjit nga Gjykata e Lartë

19. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatë së Lartë ka gabuar në interpretimin dhe zbatimin e ligjit për pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik (kontratës së shitblerjes) që ka ndikuar drejtpërsëdrejti në marrjen e vendimit nga ana e saj.

20. Gjykata ka ritheksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material është, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e Gjykatës

Kushtetuese është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 4, datë 05.02.2014; nr. 34, datë 12.07.2013; nr. 1, datë 20.01.2012; nr. 23, datë 17.05.2011; nr. 31, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit, i parashtruar sa më sipër, është i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

22. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se me qëndrimin ndaj fitimit të pronësisë që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka mbajtur në vendimin që kundërshtohet, cenon parimin e sigurisë juridike në lidhje me pronën private të fituar shumë vite më parë.

23. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim i cili pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit te shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në diskutim (*shih vendimet nr. 24, datë 12.11.2008 dhe nr. 23, datë 08.06.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin konkret nga faktet rezulton se kërkuesi, me anë të kontratës së sipërmarrjes nr. 1916 rep., nr. 448 kol., ka marrë nga pronarët (shtetasit L.D., B.D., dhe E.D.) truallin prej 200 m2 për të ndërtuar një objekt. Pronarët e këtij trualli e kanë fituar pronësinë me anë të një kontrate shitblerjeje. Më pas me anë të një kontrate tjetër shitblerjeje ata kanë fituar pronësinë mbi një sipërfaqe trualli prej 262 m2, në funksion të ndërtimit që kërkuesi do të kryente në truallin prej 200 m2. Duke e vlerësuar pretendimin e kërkuesit kundrejt rrethanave faktike, si më sipër, Gjykata konkludon se argumentet e kërkuesit për cenimin e sigurisë juridike në lidhje me të drejtën e fituar të pronësisë nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Në këto kushte Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

25. Si përfundim, në këndvështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se në rastin konkret është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja "g", të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2013-1773 (422), datë 09.07.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM
Nr. 41, datë 25.6.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i " "
Sokol Berberi	anëtar i " "
Vitore Tusha	anëtare e " "
Altina Xhoxhaj	anëtare e " "
Gani Dizdari	anëtar i " "
Besnik Imeraj	anëtar i " "
Fatos Lulo	anëtar i " "
Fatmir Hoxha	anëtar i " "

me sekretare Edmira Babaj, në datën 12.03.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 10 Akti, që i përket:

KËRKUES: Durim Grabova

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, Tiranë, Shoqëria e Përmbarimit "Albase" sh.p.k., Tiranë

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 79, datë 13.12.2013 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 1, 131, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 27, 28, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të kërkuesit, si dhe prapësimet e subjektit të interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi Durim Grabova prej datës 24.12.2007 ka kryer detyrën e drejtorit pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Metrologjisë Tiranë.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Metrologjisë, Tiranë me urdhrin nr. 745, datë 26.09.2013 "Për zgjidhjen e kontratës së punës", ka urdhëruar shkëputjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare për kërkuesin. Pas disa ankimeve drejtuar institucioneve në rrugë administrative, kërkuesi Durim Grabova i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me padi me objekt detyrimin e palës së paditur, Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë Tiranë, për kthimin në punë dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ nr. 745, datë 26.09.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Metrologjisë.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 79, datë 13.12.2013, ka vendosur pranimin e padisë së kërkuesit dhe detyrimin e të paditurit të kthejë në vendin e punës kërkuesin. si dhe pagesën e pagës deri në momentin e rikthimit në detyrë. Ndaj këtij vendimi nuk është bërë ankim dhe në datën 06.01.2014 ai ka marrë formë të prerë.

4. Kërkuesi në datën 20.01.2014 i është drejtuar me shkresë shoqërisë përmbarimore "Albase" sh.p.k. për të filluar procedurat e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

5. Shoqëria përmbarimore "Albase" sh.p.k. i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë me shkresa për ekzekutimin vullnetar të detyrimit dhe për vënien e sekuestros konservative, duke urdhëruar vendosjen e masës së sekuestros konservative në llogarinë ë gjendjes në thesar të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

6. Ndërkohë, kërkuesi në datën 03.03.2014 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 79, datë 13.12.2013 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Partë Tiranë.

7. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 96, datë 07.05.2014, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare me arsyetimin se afati nga momenti i procedurave të ekzekutimit deri në ankimin para Gjykatës

Kushtetuese është shumë i shkurtër dhe nuk mund të përbëjë cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

8. Në datën 01.07.2014 kërkuesi i është drejtuar përsëri Gjykatës Kushtetuese me kërkesë me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 96, datë 07.05.2014 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetues. Me vendimin nr. 144, datë 11.07.2014, ky kolegji ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, bazuar në nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit vendimet e kësaj gjykate janë me fuqi detyruese të përgjithshme dhe përfundimtare.

II

9. ***Kërkuesi Durim Grabova*** në datën 03.11.2014 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 79, datë 13.12.2013 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, pika 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

10. ***Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, ka parashtruar si vijon:***

10.1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, në zbatim të vendimit nr. 79, datë 13.12.2013 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", ka nxjerrë urdhrin nr. 19, datë 20.01.2015 "Për rikthimin në detyrë" të kërkuesit në pozicionin e mëparshëm, duke ekzekutuar detyrimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

10.2. Lidhur me dëmshpërblimin Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë e ka përmbushur pjesërisht detyrimin, në pamundësi të fondeve buxhetore për vitin 2014. Me miratimin e fondit buxhetor për vitin 2015 do të kryhet shpërblimi për pjesën e mbetur ndaj kërkuesit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës

11. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm të vendimit të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimet nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.05.2010; nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces.

13. Gjykata është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit dhe të autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, si dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë

palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.04.2010; nr. 8, datë 23.03.2010; nr. 9, datë 01.04.2009; nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Çështja konkrete është vlerësuar në vijim nga Gjykata Kushtetuese, në vështrim të respektimit të standardeve të mësipërme.

i) Kompleksiteti i çështjes

15. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, Gjykata Kushtetuese vlerëson se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së kërkuesit dhe i autoriteteve publike është me rëndësi në këtë kontekst.

ii) Sjellja e kërkuesit

16. Për sa i përket sjelljes, veprimeve të kërkuesit, nga tërësia e fakteve dhe rrethanave rezulton se kërkuesi, pas mbarimit të procesit gjyqësor për anulimin e urdhrit të largimit nga detyra, në datën 20.01.2014 i është drejtuar me shkresë shoqërisë përmbarimore "Albase" sh.p.k. për të filluar procedurat e ekzekutimit.

17. Për sa më sipër, kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke mos u bërë pengesë në përmbushjen e detyrimit.

iii) Sjellja e autoriteteve

18. Në këtë drejtim është e nevojshme fillimisht të vlerësohet nëse shoqëria përmbarimore "Albase" sh.p.k. ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e urdhrit të ekzekutimit në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë. Sipas kërkesës dhe dokumenteve të bashkëlidhura, rezulton se shoqëria përmbarimore "Albase"sh.p.k. me shkresën nr. 491/A, nr. 491/1 prot, datë 20.01.2014 "Lajmërim për ekzekutim vullnetar", i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë për ekzekutimin vullnetar të detyrimit. Njoftimi ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ka vijuar me shkresat nr. 491/A, nr. 491/2 prot, datë 28.01.2014 "Për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm"; nr. 491/A, nr. 491/3 prot., datë 28.01.2014 "Për vënien e sekuestros konservative"; nr. 491/A, nr. 491/4 prot., datë 28.01.2014 "Urdhër bllokimi", për bllokimin e dokumentacioneve të çdo automjeti që ka në pronësi debitori; nr. 491/A, nr. 491/5 prot., datë 28.01.2014 "Për vënien e sekuestros konservative në thesar". Shoqëria përmbarimore "Albase" sh.p.k. ka kryer veprime të mëtejshme. Konkretisht me kërkesën nr. 491/A, nr. 491/6 prot., datë 20.03.2014, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar urdhërimin për kryerjen e veprimeve të posaçme dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme, duke përcaktuar afatet dhe mënyrën e kryerjes se tyre, gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 79, datë 13.12.2013 dhe me urdhrin nr. 491/A, nr. 491/7 prot., datë 15.04.2014 "Për vënien e sekuestros konsvervative në thesar", ka urdhëruar vendosjen e masës së sekuestros konservative në llogarinë e gjendjes në thesar të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

19. Në lidhje me sjelljen e autoritetit tjetër, Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky autoritet ka ndërmarrë veprime për ta ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 79, datë 13.12.2013 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Konkretisht, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, me shkresën nr. 670/1 prot, datë 07.02.2014, i ka kthyer përgjigje shoqërisë përmbarimore "Albase" sh.p.k., duke i kërkuar depozitimin e dokumentacionit të plotë, në formën e kërkuar nga ligji, me qëllim fillimin e ekzekutimit të detyrimit. Me shkresën nr. 176/1 prot., datë 16.01.2015 "Për zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë" i është drejtuar kërkuesit duke i kërkuar paraqitjen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë për të rifilluar marrëdhëniet e punës pranë këtij institucioni. Me urdhrin nr. 19, datë 19.01.2015 "Për rikthimin në detyrë" është urdhëruar rikthimi në detyrë i kërkuesit, duke filluar marrëdhëniet financiare prej datës 20.01.2015. Me shkresën nr. prot. 3410 /10, datë 26.01.2015 kërkuesi është emëruar nëpunës civil në pozicionin "Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve" në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë. Lidhur me përmbushjen e detyrimit për shpërblimin e dëmit, rezulton se është paguar shuma prej 1.040.320 lekësh dhe subjekti i interesuar ka shprehur vullnetin për përmbushjen edhe të pjesës së mbetur prej 540.379 lekësh me miratimin e fondit buxhetor për vitin 2015.

20. Gjykata vlerëson se autoritetet shtetërore kanë vepruar në përputhje me të drejtat e tyre, duke treguar interes për ekzekutimin e detyrimit ndaj kërkuesit.

21. Lidhur me afatet kohore, në çështjen konkrete rezulton se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka marrë formë të prerë në datën 06.01.2014 dhe kërkuesi i është drejtuar shoqërisë përmbarimore "Albase" në datën 20.01.2014.

22. Gjykata çmon se nisur nga tërësia e rrethanave të çështjes nuk është cenuar afati i arsyeshëm kohor për ekzekutimin e detyrimit ndaj kërkuesit.

23. Si më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se në çështjen objekt shqyrtimi nuk ndodhemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji brenda një afati të arsyeshëm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f", dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM
Nr. 42, datë 25.6.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Sokol Berberi	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtare e	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 01.07.2014, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 30/3 Akti, që i përket:

KËRKUES: Sali Driza, Hamdi Driza, Dije Kazazi (Driza)

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Qemal Driza, Fatbardha Ruci (Driza), Zyra Rajonale e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 3984, datë 20.06.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1035, datë 02.10.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2012-753 (96), datë 23.02.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131/f, 132/1 dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut; nenet 27, 28, 29, 30, 31 dhe 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese së Republikës të Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuesve, të cilët kërkuan pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar Qemal Driza, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesit Sali, Hamdi dhe Deje Driza dhe subjektet e interesuara Qemal e Fatbardha Driza janë trashëgimtarë të trashëgimlënësit Ali Driza. Trashëgimlënësi Ali Driza nëpërmjet disa kontratave të dhurimit i ka kaluar të drejtën e pronësisë mbi disa prona njërit prej fëmijëve, subjektit të interesuar Qemal Driza. Konkretisht me kontratën e dhurimit të datës 08.11.1991 i ka kaluar pronësinë e pasurisë e përbërë nga një shtëpi, gjashtë dyqane dhe ambiente të tjera funksionale me sipërfaqe prej 677 m2 me kufij të përcaktuar. Me kontratën e datës 27.09.1994 i ka dhuruar pasurinë e përbërë prej truallit me sipërfaqe 190 m2, pas kthimit nga KKKP-ja Tiranë. Kërkuesit Sali dhe Hamdi Driza me pretendimin se kontratat e dhurimit kanë pasur

parregullsi, i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke paditur subjektin e interesuar Qemal Driza me padi me objekt detyrimin për të njohur të drejtën e bashkëpronësisë në të gjithë sipërfaqen e truallit 867 m2 dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave të dhurimit. Kërkuesja Dije Kazazi (Driza) dhe subjekti i interesuar Fatbardha Ruçi (Driza) janë thirrur me cilësinë e personit të tretë gjatë gjykimit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3984, datë 20.06.2005, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj dhe prova.

3. Mbi ankimin e kërkuesve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1035, datë 02.10.2006, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3984, datë 20.06.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Mbi rekursin e kërkuesve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2008-576 (166), datë 06.03.2008, ka vendosur ndryshimin e vendimin nr. 1035, datë 02.10.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 3984, datë 20.06.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e padisë, si dhe detyrimin e subjektit të interesuar Qemal Driza të njohë të drejtën e bashkëpronësisë sipas pjesëve që trashëgojnë nga pasuria e trashëgimlënësit Ali Driza.

5. Subjekti i interesuar Qemal Driza i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2008-576 (166), datë 06.03.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke argumentuar se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor.

6. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 7, datë 09.03.2009, ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2008-576 (166), datë 06.03.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-753 (96), datë 23.12.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1035, datë 02.10.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

II

8. ***Kërkuesit Sali, Hamdi dhe Dije Driza*** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me pretendimin se vendimi nr. 00-2012-753(96), datë 23.02.2012 i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke argumentuar si vijon:

8.1 Vendimet objekt gjykimi kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt në aspekt të parimit të barazisë së armëve dhe të së drejtës së mbrojtjes efektive, pasi përfaqësimi i të dyja palëve me interesa të kundërt është realizuar nga ai njëjti përfaqësues. Ky pretendim është paraqitur edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila nuk i ka dhënë përgjigje. Kërkueses Dije Kazazi (Driza), e cila ka qenë person i tretë gjatë gjykimit, i është cenuar e drejta e mbrojtjes efektive. Gjykata e Lartë, ashtu si dhe dy gjykatat më të ulëta, ka cenuar parimin e barazisë së armëve, duke cenuar të drejtën e një mbrojtje efektive.

8.2 Gjykatat nëpërmjet vendimeve të tyre kanë cenuar parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi nga përmbajtja e vendimeve rezulton se mungon parashtrimi i plotë dhe i saktë i fakteve dhe rrethanave sipas provave të administruara dhe vlerësuara gjatë gjykimit.

8.3 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-753(96), datë 23.12.2012, ka lejuar cenimin e parimit të paanësisë, të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Apelit Tiranë.

9. ***Subjekti i interesuar Qemal Driza*** paraqiti prapësime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

9.1 Pretendimi për shkeljen e parimit të barazisë së armëve, duke shkelur të drejtën e mbrojtjes efektive, është një pretendim që nuk është ngritur në rekurs apo ankim, pra nuk janë shteruar mjetet ligjore, si rrjedhojë nuk mund të bëhet objekt shqyrtimi nga Gjykatë Kushtetuese.

9.2 Pretendimi i kërkuesve për cenim të parimit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore është i pabazuar. Vendimet objekt gjykimi janë arsyetuar qartë, duke parashtruar saktë faktet dhe provat që janë administruar dhe vlerësuar, duke arritur në konkluzione të sakta.

9.3 Pretendimi i kërkuesve se Gjykata e Lartë ka lejuar shkeljen e parimit të paanësisë, të parimit të barazisë së armëve dhe të parimit të kontradiktoritetit është i pabazuar në fakte. Gjykata e Lartë në rigjykimin e çështjes së iniciuar nga kërkuesi ka respektuar konkluzionet e Gjykatës Kushtetuese, të dhëna në vendimin nr. 7, datë 09.03.2009.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimimin e kërkuesve

10. Gjykata Kushtetuese (në vijim Gjykata) vëren se bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, individët mund t`i drejtohen kësaj gjykate për gjykimin përfundimtar të pretendimeve të tyre për cenimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte.

11. Shterimi i mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, kërkon që individi të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për rivendosjen e të drejtave të pretenduara (*shih vendimet nr. 15, datë 19.04.2013; nr. 36 datë 10.11.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Kushti paraprak i shterimit të mjeteve juridike duhet të përmbushet nga kërkuesi përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 6, datë 04.03.2010; nr. 32, datë 28.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjithashtu, Gjykata thekson se kriteri kushtetues i "detyrimit për të justifikuar interesin", i përcaktuar në pikën 2 të nenit 134 të Kushtetutës, është interpretuar nga jurisprudenca kushtetuese si përcaktues i ndarjes së rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori, subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Gjykata vëren se në rekursin e paraqitur nga kërkuesit Sali dhe Hamdi Driza në Gjykatën e Lartë pretendimi për cenim të parimit të barazisë së armëve, të parimit të mbrojtjes efektive dhe atij të paanësisë nuk është parashtruar. Shkaqet mbi të cilat është mbështetur rekursi janë të lidhura me zbatimin e gabuar të ligjit material për pasurinë e paluajtshme objekt të kontratave të dhurimit apo zbatimin e gabuar nga Gjykata e Apelit të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë.

13. Në këtë kuptim, kërkuesit Sali dhe Hamdi Driza si subjekte të kushtëzuara, të parashikuara në shkronjën "g" të paragrafit 1 të nenit 134 të Kushtetutës, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Pretendimet konkrete që ngrenë kërkuesit kanë të bëjnë me kërkuesen tjetër në gjykimin kushtetues Dije Kazazi. Rezulton se gjatë gjykimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kërkuesja Dije Kazazi ka qenë në cilësinë e personit të tretë.

14. Gjykata vlerëson se cenimi i parimit të barazisë së armëve, i mbrojtjes efektive, dhe ai i paanësisë lidhen me të drejta që i takojnë personit të tretë në gjykimin e zakonshëm, si rrjedhim kërkuesit Sali dhe Hamdi Driza nuk legjitimohen për të ngritur pretendimet e mësipërme në gjykimin kushtetues.

15. Për kërkuesen Dije Kazazi Gjykata vlerëson se nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese pasi nuk ka shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave.

16. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen vetëm për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë

17. Kërkuesit kanë pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-753(96), datë 23.12.2012, ka cenuar parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi nuk u ka dhënë përgjigje të detajuar të gjitha pretendimeve lidhur me shkeljet e kryera nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, si dhe nuk ka parashtruar në mënyrë të plotë dhe të saktë faktet dhe rrethanat sipas provave të administruara dhe vlerësuara gjatë gjykimit.

18. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës.

Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 23.01.2014; nr. 3, datë 19.02.2013; nr. 20, datë 13.04.2012; nr. 8, datë 16.03.2011; nr 38, datë 30.12.2010; nr. 7, datë 09.03.2009; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese)*. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre.

19. Në çështjen konkrete Gjykata vëren se në vendimin e kundërshtuar të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 1035, datë 02.10.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë, janë pasqyruar në pjesën e tij hyrëse: palët ndërgjyqëse, objekti i padisë, disponimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë, vendimi nr. 00-2008-576 (166), datë 06.03.2008 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimi nr. 7, datë 09.03.2009 i Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar vendimin nr. 00-2008-576 (166), datë 06.03.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe fakti se çështja është kthyer për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

20. Nga përmbajtja në tërësi e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se rrjedha logjike e përdorur është e qartë, e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese, duke pasqyruar faktet dhe rrethanat bazuar në provat e administruara gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Apelit Tiranë.

21. Për sa më sipër Gjykata vlerëson se Kolegji Civil të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-753(96), datë 23.12.2012, nuk ngre dyshime lidhur me cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

22. Gjykata Kushtetuese konstaton se vendimi nr. 00-2012-753(96), datë 23.12.2012 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është marrë pas një periudhe kohe më shumë se tre vjet nga shpallja e vendimit nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin është vendosur shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2008-576 (166), datë 06.03.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

23. Në këtë kuadër Gjykata Kushtetuese sjell në vëmendje respektimin e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, i parashikuar në pikën 2 të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si një nga komponentët e rëndësishëm të zhvillimit të procesit të rregullt ligjor.

24. Në përfundim Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit në këtë aspekt është i pabazuar dhe se kërkesa nuk përmban shkaqe që mund të lidhen me cenimin e ndonjë prej elementeve të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja "g", të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë